RAPORTI VJETOR 2015

Përgatitur për

MBLEDHJEN E KUVENDIT TË STIKK



24 Mars, 2016

Ora 09:00

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA 2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
Publikimet gjatë vitit 2015 6
Mbledhjet e bordit 6
Stafi i STIKK 6
Anëtarët e STIKK 6
Të hyrat dhe shpenzimet 6
Auditimi i financave të STIKK 6
AKTIVITETET 7
Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK 7
Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut 20
Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore 25
Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut 30
Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK 32
TË HYRAT DHE SHPENZIMET 33
Të hyrat 33
Shpenzimet 34
MBLEDHJET E BORDIT 36
PËRMBYLLJE 38

STIKK në 2015

Anëtarësimet e reja

Kompani	20
Profesionist	4
Student	1

3 Projekte

spark ignites ambition
NORWEGIAN EMBASSY
german cooperation DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by: giz

KOSICT
SEE IT
spark ignites ambition IGNITE! 2015

10+ Konferenca

2 Publikime

2 Udhëtime B2B
të organizuara:
BERLIN & VJENË



4,309 Njerëz na pëlqejnë në

1,364 Njerëz na ndjekin në

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjate periudhës së njëvjeçare të vitit 2015 janë realizuar aktivitete të cilat janë në përputhshmëri me pesë (5) objektivat e STIKK:

- **Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK**
- **Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut**
- **Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore**
- **Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut**
- **Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK**

Nën objektivin e parë të strategjisë së STIKK janë ndërmarr aktivitete të cilat mbështesin rritjen e sektorit të TIK. Disa nga aktivitetet me ndikim më të madh në saje të objektives janë: Pakoja e re fiskale, vendimi i Qeverisë për Inkubatorin për IT Biznese dhe aprovimi i Strategjisë Nacionale të IT-së nga Qeveria e Kosovës.

Nën objektivin e dytë, zhvillimi i burimeve njerëzore ose zhvillimi i fuqisë punëtorë në TIK është njëra prej shtyllave kryesore për një rritje të qëndrueshme të sektorit. Disa nga aktivitetet për këtë vit janë: Salesforce trajnimi nga Spark, lansimi i projektit STIKK Education, IT Barometer 2015 për Kosovën.

Objektivi i tretë ku caku është krijimi dhe zhvillimi i mundësive biznesore për anëtarët duke fuqizuar dhe zgjeruar rrjetin biznesor të tyre. Disa prej aktivitete që mbështesin këtë objektive janë: #KosICT15, Konferenca e TI-së së Evropës Jug-Lindore, punëtoritë për Export Promotion Services dhe Innovation Hub.

Objektivi i katërt ku krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme u mbështet nga këto aktivitete: Kuvendi i VII i STIKK, Interesimi i minoritetit Serb për anëtarësim në STIKK, Lansimi i www.stikk.org.

Në fillim te këtij viti janë realizuar pak aktivitete të ndërlidhura me financim të donatorëve, për shkak se këtë vit donatorët kishin vonesa kohore në vlerësim dhe aprovim të projekt propozimeve te dërguara nga STIKK. Kjo ka shkaktuar qe edhe numri i stafit të angazhuar në STIKK të jetë me i vogël krahasuar me te njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Hezitimet e donatorëve aktual kanë rezultuar edhe nga pasiguria e gjashtëmujorit të dytë të vitit të kaluar, në kohën e mosfunksionimit te Qeverisë. Pasojat e kësaj pasigurie politike, kanë ndikuar që edhe në STIKK të ketë shumë më pak projekte që do të adresonin aktivitetet e planifikuara në Planin e punës për vitin 2014.

Megjithatë, një hap përpara është bërë ne lobim dhe avokim, ku STIKK është pozicionuar si akterë shumë i rëndësishëm në çështjet e TIK. Me themelimin e Qeverise së re, sektorit të TIK i është dhënë prioritet, dhe kjo është reflektuar me takime të shumta të realizuara me ministrat e rinj si z. Blerand Stavileci, Ministër i MZHE-së, z. Arban Abrashi, Ministër i MPMS-së, znj. Hykmete Bajrami, Ministre e MTI-së, si dhe z. Kadri Veseli, Krye-Parlamentar i Kuvendit. Janë marr premtime të shumta, një pjese e të cilave priten të realizohen gjatë këtij viti (ligji për TVSH, Parku i Teknologjisë dhe Biznesit, Fondi për Zhvillim, dhe disa të tjera).

Çereku i dytë i këtij viti vazhdoi me vështirësi në realizimit të aktiviteteve, pasojë e së cilës ishte mungesa e financimit nga donatorët. Ky trend filloi që nga gjysma e dytë e vitit të kaluar, kur situata jo-stabile politike në Kosovë ka bërë donatorët të hezitojnë për financim të çfarëdo lloji. Vonesat në përgjigje dhe prioritarizimi i kuadrove të tjera nga ana e donatoreve shkaktuan shtangim të disa aktiviteteve të STIKK.

Përkundër këtyre vështirësive, STIKK qëndron ndër akterët kryesor të sektorit të TIK në vend. Rekomandimet të bëra të STIKK veç po bëhen realitet, gjë që më së miri shihet në ligjin për TVSh dhe Fondin për Teknologji të Informacionit dhe Inovacionit.

Çereku i tretë për vitin 2015 tregoi potencialin e pashuar të STIKK në lobim për sektorin e TIK. Aktivitetet për këto tre muaj përfshijnë një tregim suksesi për organizatën, ku pas 2 vjet lobimi dhe avokimi, Administrata Tatimore e Kosovës nxjerr Udhëzimin Administrativ në të cilin pajisjet e TIK do të kenë normën e reduktuar të TVSH prej 8%.

Përveç lobimit të suksesshëm, STIKK së bashku me 5 shoqata të TIK të rajonit (AITA, BIT Alliance, MASIT, IT Cluster, ICT Network) përgatiti një hulumtim të titulluar "South-East Europe IT Barometer", i cili përkrahet nga GIZ. Qëllimi i këtij hulumtimi është të mbledh informata relevante për industrinë rajonale të softuer-it/TI-së në mënyrë që të përgatitet një plan për eksport, si dhe masat përkrahëse për të promovuar eksportin në rajon.

Analiza e mangësisë së shkathtësive në TIK është hulumtimi i radhës prej STIKK i zhvilluar nga UBO Consulting. Kjo analizë tregon mangësinë e shkathtësive për fuqinë punëtore në sektorin e TIK.

STIKK Education merr mbështetje nga GIZ, Ambasada Norvegjisë në Prishtinë dhe Empower i USAID-it. Kjo mbështetje ka për qëllim trajnimin dhe punë praktike për të rinjtë në fushën e TIK.

Çereku i fundit i këtij viti përmbajti aktivitete të ndryshme dhe të rëndësishme për STIKK dhe tregun e TIK. Disa ndër aktivitetet kryesore për këtë periudhë ishin:

- KosICT – Këtë vit u tregua potenciali i një ngjarje si KosICT ku tema globale u shtjelluan për partnerë dhe individë të ndryshëm që ishin të pranishëm në ngjarje;
- EPS & Innovation Hub – Punëtori për Export Promotion Services dhe Innovation Hub;
- STIKK Education – Ky shërbim fillimisht do të shërbej si mundësi trajnimi për të rinjtë e papunësuar me vizion që të ofrohet një hapësire edukuese ku fuqia punëtorë e TIK ka mundësinë që të zhvillohet;
- CBC Istog-Berane – Takimi u zhvillua me 3 Dhjetor 2015 në Beranë, me diskutimet që u zhvilluan, aktivitetet dhe implementimi i tyre u qartësua nga të 2 palët regjionale.

Viti 2015 është përmbyllur me dy vendime Qeveritare të cilat do të ndihmojnë tutje sektorin e TIK: iniciativa për zhvillimin e Inkubatorit të IT Bizneseve, ku parashihet që STIKK dhe kompanitë anëtare të jenë përfitues të drejtpërdrejt (vendimi nr. 10/65) dhe aprovimi i Strategjisë Nacionale të IT-së e përgatitur nga STIKK, MZHE dhe palëve të tjera të interesit (vendimi nr. 14/67).

Me aktivitetet, ngjarjet dhe punëtoritë e këtij viti, STIKK si organizatë është e gatshme për një KosICT më të rrjetëzuar, zhvillim progresiv të brendshëm, zhvillim të fuqisë punëtore në TIK, bashkëpunim ndërmjet regjioneve kufitare përmes projektit (CBC).

Publikimet gjatë vitit 2015

- Studimi "IT Barometer Kosovo 2015":
  http://stikk.org/fileadmin/user_upload/it_barometer_kosovo-2015_eng.pdf
- Studimi "Identifikimi i nevojave të tregut të punës në sektorin e TIK-ut":
  http://stikk.org/fileadmin/user_upload/Skills_Gap_2015__SQ__-_v5__21.12.2015_.pdf

Mbledhjet e bordit

Gjatë vitit 2015 u mbajtën gjithsej tre mbledhje të rregullta të Bordit të STIKK (11 Shkurt, 13 Maj dhe 15 Shtator).

Stafi i STIKK

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, janë bërë disa ndryshime në stafin e STIKK:

Gjatë kësaj periudhe, Egzon Gashi ka filluar praktikën nga data 01.01.2015 deri me 31.03.2015 dhe Lorik Mullaademi është avancuar në pozitën e Menaxherit të Projekteve nga data 01.01.2015. Gjatë kësaj periudhe, Engjëll Kozhani ka filluar praktikën nga data 01.05.2015 deri më 31.07.2015, ndërsa punës ia filluan Egzon Gashi me pozitë Asistentit i Projekteve nga data 01.04.2015 dhe Mimoza Bardhi si Menaxhere e Administratës dhe Financave nga data 01.05.2015. Nga STIKK vullnetarisht është larguar Fatmire Asllani pas përfundimit të kontratës së punës me 15.04.2015.

Dy praktikant I bashkëngjiten ekipit të STIKK. Me datën 01.11.2015 Liridona Abdullahu dhe Agon Ukaj filluan punën praktike që do të zgjasë deri me 31.01.2016.

Anëtarët e STIKK

Gjatë viti 2015, janë anëtarësuar 20 Kompani të reja nga të cilat 5 kompani të minoritet serb: Art House, PrimeDB, DY Gur, Red Mill, Bit Kosova, Katrori ITS, Ilir Kosova, Kosovo Guide, Infosoft System, MikroBIZ, Scards, Translation Centre, Microsoft Dooel Skopje, Manafera, Open Research, SA electronic, Techland, VGN NET DOO, U.T.P. "S.P.I.", KaleMedia. Gjithashtu kemi pasur 4 anëtarësime të reja të anëtarëve profesional dhe 1 anëtarësim student.

Gjatë vitit 2015, kemi pasur 3 kompani të cilat janë tërhequr nga anëtarësimi në STIKK: ePayTech, Logistics Plus, dhe King ICT. Pas revidimeve të kompanive anëtare, tani STIKK numëron 53 anëtarë me anëtarësim të plotë (45 kompani, 7 profesionist, 1 studente dhe 7 institucione arsimore).

Të hyrat dhe shpenzimet

Gjatë vitit 2015, të hyrat e STIKK ishin 375,471.07€ (15.04% më shumë krahasuar me 319,007€ të vitit 2014), ndërsa shpenzimet kapin shumën prej 202,685.96€ (38.08% më pak krahasuar me 325,881€ në vitin 2014).

Auditimi i financave të STIKK

Kompania audituese e pavarur “Balluku & Zhaveli”, e përzgjedhur nga anëtarët e STIKK në Mbledhjen e Kuvendit 2014, do të bëjë auditimin e të gjitha transaksioneve dhe procedurave financiare të STIKK për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor 2015. Ky auditim do te realizohet gjatë muajit Shkurt, ndërsa raporti do te prezantohet në Mbledhjen e Kuvendit 2016.

AKTIVITETET

Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK

17 Janar 2015

TAKIM ME MINISTRIN STAVILECI

Me kërkesën e vet Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, z. Blerand Stavileci, me 17 Janar, STIKK organizoi një takim për anëtarët e saj për të diskutuar situatën aktuale, nevojat dhe mundësitë e sektorit të TIK.

STIKK gjithashtu i prezantoi pjesëmarrësve strategjinë nacionale të zhvillimit të sektorit, modulet, shtyllat dhe planifikimin e implementimit. Ne anën tjetër, Ministri Stavileci edhe njëherë theksoi gatishmërinë e Qeverisë për ta vendosur si sektor prioritar TIK-un dhe gjithashtu përmendi planin e tij për krijimin e një fondi që do t'i ndihmonte zhvillimit të sektorit të TIK. Nga STIKK-u kërkoi që t'i dërgojë propozimin për shkallëzimin e TVSH për pajisjet e IT si dhe draft propozimin për Marrëveshjen G2G e cila në fokus e ka gjithashtu zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit të TIK. Zotimi i Ministrit për të qenë zëdhënës dhe përkrahës i sektorit në të gjitha institucionet relevante, gjithashtu nuk mungoi.

09 Shkurt 2015

CYBERSECURITY ROUND-TABLE DISCUSSION (WORLDBANK)

The World Bank

Zyra e BE-së në Kosovë vazhdon praktikën e saj për të pasur konsultime me organizatat e shoqërisë civile për Dialogun e Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA).

Dialogu i PSA është një kornizë në të cilat Bashkimi Evropian dhe administrata e Kosovës rregullisht diskutojnë çështje teknike dhe të politikave, si dhe reformat e tyre. Çdo takim rezulton në veprime të rëna dakord bashkërisht që do të merren parasysh nga autoritetet e Kosovës, ndërsa përfundimet dhe të dhëna nga këto takime janë të inkuadruara në Raportet Vjetore të Progresit. STIKK-u përfaqësoi zhvillimet e fundit në sektorin e TIK-ut, ku u përmenden tema si strategjia nacionale, mangësitë në edukim dhe planët e veprimit në të ardhmen.

20 Shkurt & 18 Mars 2015

PËRZGJEDHJA E KOMISIONIT PUNUES PËR ÇËSHTJE TË LEGJISLACIONIT

Me 20 Shkurt 2015, STIKK ftoj anëtaret e saj për të vazhduar punën për projektligjin për mallrat e liruar nga tatimi doganor i cili nuk ka përfshirë të gjithë listën e pajisjeve të cilat STIKK kishte propozuar si dhe për të diskutuar rreth Projektligjit për TVSh. Pjesëmarrës ne ketë takim ishin z. Enver Doko nga kompania Comtrade, z. Yll Xhemajli nga kompani ITD Kosova, z. Bekim Spahiu nga kompani CACTTUS, z. Armend Budima nga kompania Asseco, z. Gezim Paci nga kompania RIKON, znj. Blerina Rexhaj nga kompania Art House. Gjatë takimit është diskutuar rreth produkte të cilat duhet të jenë pjesë e zgjerimit të listës për mallrat e liruar nga tatimi doganor si dhe përpilimin e listës se produkteve të TIK për lirim nga TVSh, ndër të tjera në mënyrë unanime është përzgjedhur kryetari i komisionit për legjislacion z. Enver Doko.

Me 18 Mars, Drejtoresha Ekzekutive e STIKK, znj. Vjollca Çavolli së bashku me anëtaret e grupit punues për legjislacion, më saktësisht z. Enver Doko dhe z. Armend Budima, u takuan me z. Ali Lushi nga Ministria e Financave dhe z. Nahit Sharku nga Administrata Tatimore e Kosovës, njëkohësisht kryetari i grupit punues për Projektligjin për TVSh. Gjatë këtij takimi është diskutuar rreth normave të caktuara në projektligjin për TVSH për lirim e produktet e TIK, me ç'rast STIKK ka kërkuar që përveç lirimit të TVSH-së në import për produktet e TIK, të përpilohet një listë me produktet elementare të TIK të cilat do të kenë normën e reduktuar të TVSH në 8%, ndërsa pjesa e mbetur të ngarkohet me normën standarde në vlerë prej 18%.

Pas këtij takimi, në zyre të STIKK është mbledhur grupi punues për legjislacion, të cilët kanë punuar në identifikimin e grupeve tarifore të TIK të cilat janë do të kenë ndikim në zhvillimin e të gjitha sektorëve si dhe në vetë shoqërinë e Kosovës, duke ulur koston e pronësisë së këtyre pajisjeve. Lista e përgatitur i është dërguar Ministrisë së Financave, të cilët kanë dhënë premtim se kjo listë do të inkorporohet në projektligjin e TVSH. Megjithëse në listën e dërguar nuk janë të përfshira të gjitha pajisjet e TIK, kjo listë jep një bazë të mirë mbi të cilën mund të ndërtohen kërkesat tjera në të ardhmen.

25 Shkurt 2015

DISKUTIMI RRETH SHKALLËS SË PAPUNËSISË JOAKTIVE TEK GRATË

Me 25 Shkurt, Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), organizoi ngjarje për lansimin e publikimit të fundit, si dhe në diskutimin për shkallën e papunësisë joaktive tek gratë.

Ky punim argumenton se ndasia gjinore nuk është vetëm çështje e barazisë, por mund të jetë edhe barriera kryesore që pengon zhvillimin e Kosovës si shtet. Në çdo dhjetë gra në Kosovë, vetëm një prej tyre ka një punë zyrtare, dhe një është duke kërkuar punë. Vetëm këto të fundit kualifikohen si të papuna. Tetë gratë e tjera, mbesin jashtë ekonomisë monetare zyrtare, edhe pse shumë prej tyre japin kontribut të vlefshëm në shoqëri.

02 Mars 2015

KONSULTIME TË SHOQËRISË CIVILE NË TAKIMIN E DIALOGUT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT

STIKK morri pjesë në konsultime të shoqërisë civile në takimin e dialogut të Stabilizim-Asociimit. Temat të prekura në këtë takimin ishin Inovacioni, burimeve njerëzore, politikave shoqërore dhe shoqërisë së informacionit. Përveç STIKK, pjesëmarrës ishin nga organizata dhe kompani të ndryshme.

SPAD është një kornizë me të cilën Bashkimi Evropian dhe Kosova diskutojnë rreth çështjeve teknike dhe politik-bërëse, si dhe të iniciojnë reformim për zhvillim të vendit.

27 Janar 2015

KONFERENCA RAJONALE ”PRIVATËSIA NË EPOKËN DIXHITALE”

Nën patronazhin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me 27 Janar u mbajt Konferenca Rajonale “Privatësia në Epokën Dixhitale”, ku pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e agjencive simotra nga shtetet e rajonit si dhe përfaqësuesit e Facebook-ut, Google, Microsoft, Deloitte, Hewlett Packard, etj. Temat kryesore prekën rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave në Kosovë, si dhe kornizën legjislative që fuqizon këtë fushë. Si pjesë e dytë e konferencës ishte prezantimi i punimeve të nxënësve të shkollave pjesëmarrëse në këtë projekt, ku njëkohësisht u bënë edhe vlerësimet e punës simuluese që bënë hakerët etik në zbulimin e brishtësive të web faqeve të caktuara. Ekipet e nxënësve që kishin zhvilluar fushatë vetëdijësuese me moshatarët e tyre gjate javës se privatësisë, u shpërblyen me bursa studimi, libra, trajnime, e kështu me radhë.

10 Shkurt 2015

KONFERENCA “DITA E INTERNETIT TË SIGURT”

Në kuadër të Ditës së Internetit të Sigurt, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Qendrën për Studime të Avancuara (FIT) organizoi një konferencë, në të cilën u prezantua projekti PROCON (Mbrojtja e Fëmijëve në Internet) i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Gjithashtu, u prezantua edhe strategjia e zhvilluar në kuadër te këtij projekti, pjesëmarrës aktiv i të cilës ishte edhe STIKK. Kjo strategji parasheh disa objektiva për mbrojtjen e fëmijëve nga përdorimi i pakontrolluar i internetit.

Në konferencë ndër të tjera u tha se më shumë se 76 për qind e fëmijëve në vendin tonë kanë qasje të pakontrolluar në internet, ku përveç informimit kanë qasje edhe në përmbajtje të papërshtatshme për ta.

Si përfundim, në konferencë u thanë disa objektiva të planit strategjik për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet, gjithashtu u dhanë disa rekomandime nga të pranishmit së bashku me panelistët që vëmendje kryesore duhet t’u kushtohet institucioneve arsimore, si nxënëseve ashtu edhe mësimdhënësve, gjatë përdorimit të internetit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga pasojat e tij.

11 Shkurt 2015

ICT AWARDS TIRANA

Me 11 Shkurt 2015 STIKK mori pjesë në lansimin e IT Awards për vitin 2014 e cila u mbajt ne qendrën Protik ne Tiranë, Shqipëri. Gjate këtij lansimi u prezantuan kategoritë e çmimeve për këtë vite të cilat janë: ICT Inovacioni i Vitit, ICT Akademiku i Vitit, ICT Mobiliteti i Vitit, ICT Diploma e Vitit, ICT Ylli në Ngritje, ICT Shërbimi Publik i Vitit dhe ICT Femra Inovatore e Vitit. Gjatë këtij lansimi STIKK shfrytëzoi rastin që të bisedoj me organizatoret për mundësi të bashkëpunimit ndërmjet ICTSMedia dhe STIKK. Mirëpo pasiqe ata kërkonin vetëm mjete financiare dhe nuk pranonin ndihmë (asistence teknike nga STIKK) nuk arritëm ndonjë bashkëpunim.

13 Maj 2015

FORUMI PËR TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT (TI) DHE INOVACIONIT

Me datë 6 Maj u mbajt forumi për Teknologjinë e Informacionit (TI) dhe Inovacionit. Ky forum është një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik që ka për qëllim mbledhjen e akterëve kryesorë vendimmarrës të fushës së TI-së, e cila diskuton çështje të rëndësishme të cilat ndërlidhen me zhvillimin dhe avancimin e këtij sektori në Kosovë. Vizioni i Forumit për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacion mbështetet në opinione, eksperienca, politika, reforma dhe rekomandime të elaboruara dhe relevante në fushën e TIK-ut.

Në panelet të cilat u mbajtën në këtë forum morën pjesë ekspertë ekonomik, akademik, institucione qeveritare, kompani të sektorit të TI-së dhe inovacionit si dhe donatorëve potencialë, të cilët do të kontribuojnë në krijimin e mundësive për një dimension dhe realitet të ri të strategjisë kombëtare e TI-së. Këtu morën pjesë dhe përfaqësues të STIKK. Z. Shkumbin Brestovci, tregoi për rëndësinë e parkut të biznesit dhe teknologjisë dhe kërkoi nga qeveria përkrahje për realizimin e këtij projekti me rëndësi të posaçme për zhvillimin ekonomik të vendit.

Znj. Vjollca Çavolli tregoi për sfidat me të cilat ballafaqohen bizneset, duke marrë parasysh normat e larta të interesit bankar, mungesën e fondeve zhvillimore si dhe mungesën e përkrahjes së qeverisë në aspektin e lehtësirave tatimore për kompanitë që kanë për synim eksportin e shërbimeve. Në fund ministri z. Blerand Stavileci u zotua në emër të qeverisë për përkrahje të vazhdueshme drejt zhvillimit të këtij sektori me rëndësi.

18 Maj 2015

MZHE LANSON FONDIN PËR TI DHE INOVACIONIT

Bashkëpunimi i filluar në vitin 2014 në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe STIKK ka rezultuar me përpilimin e Strategjisë Kombëtare të TI-së. Fondi për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit si pjesë e strategjisë, ishte rekomandim nga ana e STIKK, të cilën Ministri i MZHE-së, z. Blerand Stavileci, e mori parasysh në mënyrë që të mbështeten kompanitë e reja dhe ato në rritje mbi bazën e konceptit të bashkëpunimit publiko-privat.

Fondi do të adresonte disa nga problemet kyçe dhe pengesat për qasje në financa, ndërsa Qeveria do të ndajë një fond investiv prej 2 milionë Euro, i cili do të përputhej me një fond shtesë nga donatoret prej 2 milionë Euro dhe do të nxiste fillimisht dhe 2 milionë Euro investime nga sektori privat, duke arritur një total prej 6 milionë Euro.

03 Prill 2015

DITA NDËRKOMBËTARE E FEMRAVE NË TIK

Me 23 Prill u mbajt ngjarje për njohjen e Femrave në Ditën Ndërkombëtare të TIK, në kampus të AUK. Qëllimi i kësaj ngjarje ishte që të bëhet një përpjekje globale për të rritur ndërgjegjësimin, për të fuqizuar dhe inkurajuar vajzat dhe gratë e reja që të i marrin parasysh studimet dhe karrierën në TIK.

Ngjarja mblodhi së bashku femra të interesuar në profesionin TIK. Kjo ngjarje organizoi një panel diskutimi duke përfshirë znj. Vjollca Çavolli, Drejtoreshë Ekzekutive STIKK, z. Bernard Nikaj, ish-Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, znj. Burbuqe Hana, Koordinatore VALA për Sigurimin e Cilësisë dhe znj. Iliriana Nreca, Web Developer.

12 Maj 2015

TAKIM I KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI, KULTURË, RINI DHE DIASPORËS ME SHOQATAT ME ANËTARËSI

Me 12 Maj, u mbajt takimi në mes Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Diasporë dhe shoqatave/grupeve të interesit, që u organizua nga komisioni në fjalë dhe Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D).

Në këtë takim ku dhe STIKK ishte prezent, pjesëmarrësit përveç që patën mundësi të njihen me planin e punës së komisionit, atyre u rekomandua që çdo koment që kanë për draft-ligjet apo dokumentet në të ardhmen të jenë me shkrim, pasi që vetëm shkresat zyrtare do të merren parasysh dhe do t'iu përcjellën institucioneve përkatëse.

15 Maj 2015

VAJZAT NË SEKTORIN E TEKNOLOGJISË

Sektori i teknologjisë ofron mundësi të mëdha punësimi, veçmas për vajzat, por ky sektor nuk është parë deri tani si atraktiv nga kjo pjesë e popullatës. Ambasada Norvegjeze në Prishtinë ka financuar një projekt që synon të rrisë përfshirjen e vajzave të Kosovës në këtë industri. Aktualisht, struktura gjinore e punonjësve në sektorin e Teknologjisë së Informacionit është 80% meshkuj dhe 20% femra.

Me 15 Maj, KS-Kosova organizoi një konferencë ku u diskutua çështja e femrave në TI dhe u bë prezantimi i projektit rreth kësaj teme. Ky projekt përqendrohet në nivelin e hershëm arsimor të grave, në arsimin e mesëm për rritjen e punësimit të femrave në sektorin e TIK-ut dhe gjithashtu fuqizimin e pozitës së gruas në ekonominë e Kosovës.

Përveç Ambasadorit Norvegjez, panelist në këtë ngjarje ishin edhe Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi, Drejtoresha Ekzekutive e STIKK, znj. Vjollca Çavolli, si dhe akterë të tjerë me rëndësi të posaçshme në sektorin e TIK.

29 Maj 2015

MISIONI I EKSPERTËVE "TAIEX" PËR STATISTIKAT E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Më 26 Maj, nën patronazhin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe me ndihmën e eksperteve të TAIEX-it u organizua një punëtori tre-ditore mbi temën Statistikave të Shoqërisë së Informacionit. Qëllimi i këtij misioni të ekspertëve ishte mbështetja e institucioneve në krijimin e një sistemi statistikor në përputhje me standardet evropiane dhe EUROSTAT për të prodhuar statistika të sakta mbi teknologjinë e informacionit.

Dita e parë përmblodhi tema rreth Legjislacionit të BE-së në lidhje me statistikat e Shoqërisë së Informacionit, dita e dytë rreth Statistikave të TIK për ndërmarrje dhe dita e tretë rreth Statistikave të TIK për ekonomi familjare.

Me këtë rast u formua grupi i punës me përbërje: STIKK, MZHE, MAP, Agjencioni Statistikor i Kosovës dhe ARKEP, të cilët do të jenë përgjegjës për konceptimin e pyetësorit në të ardhmen.

22 Shtator 2015

PAKOJA E RE FISKALE

Sipas ligjit nr. 05/l-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Neni 26, pika2, pajisjet e teknologjisë së informacionit hyjnë në mesin e produkteve esenciale të cilave iu zbritet TVSH-ja, ligj ky i cili hyn në fuqi me 1 Shtator, 2015. Për më tepër, këto të njëjtat pajisje lirohen nga TVSH në import.

Ndikimi i zbritjes së TVSH-së për sektorin e TIK në Kosovë mund ta analizojmë me një krahasim.

16% TVSH	8% TVSH
Vështirësi për investitor në sektorin e TIK	Furnizim më i thjesht dhe i shtuar me qëllim te përmbushjes/rritjes së kërkesave të tregut të TIK
Kosto e lartë për importimin e produkteve te TIK	Tregu më fleksibil (Liquid market)
Tregu i ngurrët (Rigid market)	Nxitje/Motivim të shtuar për zhvillimin dhe përhapjen e TIK
Nxitje/Motivim të rezervuar për implementimin dhe zgjerimin e TIK	Zgjerim dhe zhvillim të rrjeteve kompjuterike dhe biznesore (Computer & Business networking)
	Rrjedhje më e shpejt dhe më e pasur e informacionit ndërmjet një individi, biznesi dhe institucioni

Pakoja e vjetër fiskale me TVSH 16% është një prej faktorëve qe krijoi një treg ku TIK si sektor nuk zhvillohej në të njëjtin hap me sektor të TIK në rajon dhe me gjerë. Kjo situatë e shtangimit dhe ngurtësisë së sektorit nuk krijoj hapësirë dhe nxitje të mjaftueshme për investitor në këtë industri.

Ndryshimi i pakos fiskale prej 16%TVSH ne 8%TVSH ka implikime të mëdha për sektorin e TIK në Kosovë, ky ndryshim do të rris zhvillimin dhe zgjerimin e këtij sektori dhe rrjedhimisht rrjetëzimin ndërmjet një organizate, biznesi dhe individi, ku Kosova si shoqëri do të ketë më shumë qasje në informata lokale dhe ato internacionale.

29 Qershor, 2015

EXPOFORUM

”Mënyrat e reja të financimit të projekteve strategjike Kosovë - Shqipëri” Ky ishte qëllimi kryesor për takimin ndërmjet reprezentuesve të Prishtinës, Kosovës dhe reprezentuesve nga Shqipëria, kompanive lokale dhe internacionale, po ashtu edhe donatorët.

EXPOFORUM u organizua në Hotel Emerald me bashkë organizatorë: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Diasporës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Energjetikës.

Forumi do të rezultoi me konkluzione në mundësitë te ofruara nga sektori, hapat që parashtrohen të ndërmerren prej institucioneve për qëllim të stimulimit dhe rolit te sektorit privat në zhvillimin e sektorit.

17 Shtator 2015

STRATEGJITË E SIGURISË KIBERNETIKE KOMBËTARE

Me qëllimin për hartimin sa më kompakt te strategjisë së sigurisë kibernetike të Kosovës, Ministria e Mbrojtjes ka ftuar plot partnerë të interesit që të bashkëpunojnë në këtë drejtim.

STIKK u reprezentua në ketë takim nga Lorik Mullaademi ku u dhanë komente për përmirësimin e draft strategjisë që vetëm ishte hartuar nga një grup punues ekspertësh. Në muajt e radhës pritet që kjo strategji të kompletohet dhe të dërgohet tek publiku i gjerë për komentim.

15 Korrik 2015

LAC MEETING SPARK

LAC organizohet nga SPARK, ku qellim është takimi i të gjithë partnerëve të projektit MFSII.

Në këtë takim u diskutuan rezultatet e arritura të projektit gjatë 5 viteve ku u konstatua që projekti nga Kosova ka arritur më së shumti sukses në krahasim me vendet tjera (Afrika, Azia). Në këtë takim gjithashtu është marr vendimi që përfaqësuesi i STIKK, Lorik Mullaademi, të përfaqësojë të gjithë partnerët e projektit nga Kosova në PAC mbledhjen e Nëntorit në Amsterdam, Holandë.

spark
ignites ambition

AFTËSITË DHE ZHVILLIMI I SEKTORIT TE TIK

STIKK mori pjesë në takimin rreth aftësive dhe zhvillimin në sektorin e TIK të organizuar nga kolegji UBT.

Në takim është bërë prezantimi i rezultateve nga pyetësori i quajtur "Skills demands in the field of ICT Kosovo". Këto rezultate treguan se sektori i TIK-ut ka hapësire të madhe për zhvillimin e tregut të punës për të rinjtë Kosovarë.

Përgjatë debatit të zhvilluar pas prezantimit, pjesëmarrësit shfaqën nevojën për bashkëpunim me të madh në mes të sektorit të TIK-ut, qeverisë dhe institucioneve akademike.

Një pikë e rëndësishme është se STIKK është veçuar si një urë lidhëse e këtyre tre faktorëve të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

12 Nëntor 2015

KOMUNA E PRISHTINËS

Takim i organizuar nga Qendra e Karrierës – Komuna e Prishtinës, me temë, "Kërkesat e biznesit për kuadro dhe potenciali i shkollave profesionale".

Qëllimi i këtij takimi ishte rritja e bashkëpunimit në mes të sektorit privat dhe shkollave profesionale të Komunës së Prishtinës.

16 Nëntor 2015

GEW

Java Globale e Ndërmarrësisë është festë e madhe në botën e inovatorëve dhe pune krijuesve të cilët lansojnë startups që sjellin ide të reja, shtyjnë rritjen ekonomike dhe zgjerimin e mirëqenies njerëzore.

Gjatë një jave, çdo nëntor GEW frymëzon njerëzit kudo përmes aktiviteteve lokale, kombëtare dhe globale të dizajnuara për të ndihmuar eksplorimin e potencialit të tyre si vetë-fillues dhe inovatore.

25 Nëntor 2015

ICT IN AGRIBUSINESS CONFERENCE

Si një lider në lidhjen e sektorit të TIK në Maqedoni, MASIT deri më tani ka arritur me sukses të organizojë 12 konferenca rajonale për TIK, në secilën prej tyre morën pjesë më shumë se 200 pjesëmarrës që vijnë kryesisht nga kompanitë e TIK-ut, por edhe duke përfshirë edhe zyrtarë të lartë të Qeverisë dhe ministrive, akademisë, organizatat donatore dhe akterët tjerë relevant nga rajoni i Evropës Juglindore. Duke mbledhur përvojë dhe zgjeruar kontaktet e saj jo vetëm brenda vendit, por edhe ne rajon dhe vendet ndërkombëtare, këtë vit MASIT mbajti konferencën e saj të 13 me temën "ICT in Agrobusiness" me synim te bashkimit te këtyre dy sektorëve relevant.

Qëllimi i Konferencës për këtë vit ishte për të mbledhur lojtarët e të dy sektorëve te agrobiznesit dhe të TIK në mënyrë që të paraqiten trendët nga dy sektorët, për të identifikuar potencialin për bashkëpunim, shkëmbimin e ekspertizës dhe praktikave më të mira, dhe për të inkurajuar bashkëpunimin.

08 Dhjetor 2015

MICROSOFT INDUSTRY WEEK

Microsoft organizoi dy gara kombëtare për të gjithë mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme nga Kosova.

Gara e parë është për mësimdhënës inovativ nga Kosova (Microsoft Innovative Educator - MIE). Microsoft Innovative Educator (MIE) është program ekskluziv i projektuar për të njohur mësuesit vizionar nga e gjithë bota të cilët përdorin teknologjinë në mënyrë efektive gjatë punës së tyre me nxënësit.

Shpërblime: Mësimdhënësi i cili do të përzgjidhet si Microsoft Innovative Educator (MIE) ekspert do ta përfaqësojë Kosovën në ngjarjen Microsoft Global Educator Exchange e cila do të mbahet në pranverë të vitit 2016.

Gara e dytë për mësimdhënës inovativ nga Kosova ishte në kuadër të garës rajonale MIXathon për 2015 – 2016. Gara rajonale Microsoft Miksathon (Microsoft MIXathon) Challenge është një mundësi e përkryer për t'i njohur dhe shpërblyer mësimdhënësit tonë inovativ.

Shpërblime: Fituesi i garës së bashku me pjesëmarrësit e 32 shteteve të tjera do ta përfaqësojë Kosovën në garën rajonale të Evropës Qendrore dhe Lindore.

23 Dhjetor 2015

OBJEKTI I INSTITUTIT TË NDËRTIMIT BËHET INKUBATOR PËR IT BIZNESE

Si pasoje e lobimit dhe avokimit të vazhdueshëm të STIKK në periudhën dyvjeçare, Qeveria mori vendim me 23 dhjetor 2015 (vendimi nr.10/65) që Objekti i Institutit të ndërtimit në Zonën Kadastrale Bërnicë e Poshtme, me sipërfaqe prej 8000m2 të shpallet Inkubator Biznesi për ndërmarrjet që merren me Teknologji të Informacionit.

Administrimi i këtij objekti i takon MTI-se, ndërsa parashihet që STIKK dhe kompanitë anëtare të jenë përfitues të drejtpërdrejt të kësaj iniciative.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/65
Datë: 23.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregulloret nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 Dhjetor 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Objekti i Institutit të Ndërtimit i ndërtuar në patundshmërinë e evidentuar në Certifikatën nr. 7191824-00166, parcela kadastrale nr. 1797/5, Zona Kadastrale Bërnicë e Poshtme, me sipërfaqe prej 8000 m katrorë, shpallet Inkubator Biznesi për ndërmarrjet që merren me teknologji informative.
2. Inkubatori i Biznesit për ndërmarrjet që merren me teknologji informative administrohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, konform Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike.
3. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Isa MUSTAFA
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Të dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministravë)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

30 Dhjetor 2015

STRATEGJIA NACIONALE PËR IT APROVOHET NGA QEVERIA

Në mbledhjen e Qeverisë të mbajtur me 30 dhjetor, me vendimin nr.14/67 u aprovua Strategjia e Kosovës për Teknologji të Informacionit. Kjo Strategji u punua gjatë vitit 2014 nga ana e STIKK, MZHE dhe palët tjera të interesit nën përkrahjen e GIZ dhe Ambasadës Norvegjeze. Strategjia në vetvete përmban 9 shtylla të intervenimit, implementimi i të cilave do të ndikojë dukshëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij sektori.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/67
Datë:30.12.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 Dhjetor 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia e Kosovës për Teknologji Informative.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Isa MUSTAFA
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Të dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministravë)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut

26 Mars 2015

PËRMBYLLJA E PROJEKTIT ACADEMIC EXCHANGE FOR PROGRESS (AEP)

Me 26 mars, në Tetovë u mbajt konferenca përmbyllëse e projektit trevjeçar Academic Exchange for Progress (AEP), e financuar nga Ministria e Punëve te Jashtme të Norvegjisë dhe e implementuar nga konzorciumi i përbërë nga STIKK, Universiteti i Evropës Juglindore (MK), Universiteti i Tiranës (AL), Universiteti për Biznes dhe Teknologji - UBT (KS), Kolegji Universitar i Gjøvik (NO), Universiteti i Prishtinës (KS), Crimson Capital, Athene Project Management dhe Shoqata Shqiptare e TIK - AITA.

Qëllimi i këtij projekti ka qenë shkëmbimi i njohurive përmes akomodimit të 50 studenteve te Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë për një semestër në Kolegjin Universitar ne Gjøvik, Norvegji. Për më tepër, edhe 4 magjistrave të shkencës (2 nga Kosova, 1 nga Maqedonia dhe 1 nga Shqipëria) iu mundësua vijimi i studimeve te doktoraturës.

Në konferencën e Tetovës u diskutua edhe për mundësitë e bashkëpunimit të mëtutjeshëm, pasi që u vlerësua se projekti në fjalë rezultoi si shumë i suksesshëm dhe se duhet të gjinden mënyrat për vazhdimin e tij.

Mars 2015

GRUPI KËSHILLDHËNËS PËR PROJEKTIN "VAJZAT NË TIK"

Nën mbështetjen e Ambasadës Norvegjeze dhe nën implementimin e OJQ 'KS-Kosova", filloi projekti mbi vajzat në TIK, i cili kishte si synim të promovojë pjesëmarrjen e femrave në fushën e TIK-ut duke u përqendruar në promovimin e fushës së TIK-ut tek vajzat në shkollat e mesme dhe kështu të ndikon që sa me shume vajza të zgjedhin TIK-un si profesion të tyre të ardhshëm. Në kuadër të projektit, do të zhvillohen fushata promovuese për vajzat në shkollat e mesme, do të bëhet një hulumtim i perceptimit të vajzave mbi TIK-un, dhe do të draftohet një "Punim Politikash" si rekomandim për institucionet në rritjen e pjesëmarrjes së femrave në fushën e TIK-ut.

Për të siguruar mbarëvajtjen e projektit dhe për të ofruar një përkrahje institucionale, është themeluar një grup konsultativ (pjesë e të cilit është edhe STIKK).

24 Shkurt 2015

INTERESIM I MINORITETIT SERB PËR ANËTARËSIM NË STIKK

STIKK takoi kompani të komunitetit Serb të Mitrovicës së Veriut për prezantim të shoqatës dhe mënyrave të ndryshme të anëtarësimit. Ky takim është mundësuar me ndërmjetësim të projektit Empower/USAID.

10 Mars 2015

SPARK SALEFORCE TRAINING

Me ftesë nga SPARK, STIKK mori pjesë në trajnimin rreth menaxhimit të marrëdhënieve me konsumatorët dhe në specifikë të programit të shumë-njohur SalesForce. Trajnimi u mbajt nga menaxheri për monitorim dhe vlerësim/kujdes për cilësi në SPARK, z. Anthony Gonzalez.

Z. Gonzalez sqaroi se sa e rëndësishme është mbikëqyrja sa më e lehtë e konsumatorëve dhe në veçanti qasja sa më e lehtë e stafit përgjegjës në këto informata, në mënyrë që të mënjanohen gabimet dhe të ngritët cilësia.

13 Mars 2015

CLUSTER MANAGEMENT TRAINING

Me 12 dhe 13 Mars, me përkrahje të GIZ-it, STIKK mori pjesë në trajnimin Cluster Management i cili u mbajt nga z. Lucas Von Zallinger - Capgemini. Gjatë këtyre dy ditëve stafi i STIKK pati rastin të mësoi me shumë se si funksionon një Cluster, organizimi i Clustereve dhe proceset si dhe shërbimet me specifike të cilat duhet të ketë një Cluster. Për shkak se tema mbi menaxhimin e clustereve është shumë e gjerë, ka mbet që disa pjesët si: ndërkombëtarizimi, marketingu dhe financimi i clustereve të organizohet me një punëtori tjetër.



27 Maj 2015

DISKUTIM RRETH METODOLOGJISË PËR STUDIMIN E NEVOJAVE PËR SHKATHTËSI NË TREGUN E PUNËS

Me 27 Maj në zyre të UNDP-së, u mbajt diskutimi rreth metodologjisë për studimin e nevojave për shkathtësi në tregun e punës. Pjesëmarrës ishin nga më të ndryshmit, si shoqata ashtu edhe kompani nga gjashtë sektorë të ndryshëm: TIK, përpunimi i metaleve, përpunimi i tekstilit, turizmi, përpunimi i drurit dhe tregtisë.

Për secilin nga këta sektorë u diskutua rreth mundësive të zhvillimit të tyre, temat kyçe dhe sfidat, si dhe mënyra e adresimit të tyre në të ardhmen.

14 Korrik 2015

IT BAROMETER 2015 KOSOVË

Duke krijuar traditë që nga viti i kaluar, edhe këtë vit është përgatitur Barometri i Industrisë së Teknologjisë së Informacionit (ITIB) për Kosovën. 40 kompani kosovare kanë plotësuar pyetësorin i cili përmbante 36 pyetje të ndara në gjashtë seksione:

- Informata të përgjithshme;
- Informata rreth eksportit;
- Statistika;
- Burime Njerëzore;
- Parashikime;
- Çështjet aktuale dhe Vërejtje, Komente.



Ky hulumtim për qëllim kryesorë ka identifikimin e barrierave të brendshëm që pengojnë zhvillimin e TIK në Evropën Juglindore, gjithashtu barrierat e jashtëm që pengojnë eksportin/zhvillimin biznesor jashtë vendit.
Në sektorin e TIK në Kosovë, 87% të kompanive kanë klientët e bazuar në Kosovë, ndërsa 13% (rritje prej 3.3% në vitin 2010) kanë klientët e bazuar jashtë shtetit. Kjo rritje prej 3.3% ne 13% tregon sa pak është zhvilluar eksporti në kuadër të sektorit të TIK në Kosovë, krahasuar me zhvillimin e TIK dhe teknologjisë në përgjithësi në vendet tjera.

Grafika paraqet anëtarësimin e kompanive vendore në shoqata të TIK. STIKK ka bazë të fortë ku 70% e bizneseve/individëve zgjodhën organizatën tonë për të zgjeruar rrjetin biznesor. Pas STIKK me 15% renditën bizneset dhe individët që nuk kanë anëtarësim në ndonjë shoqatë të TIK. Kjo përqindje e bizneseve dhe individëve që nuk zgjodhën të identifikohen me ndonjë shoqatë, është si rezultat i rritjes se ngadalshme të sektorit të TIK në Kosovë dhe rrjedhimisht mungesës së informatës në përgjithësi dhe specifikisht informatës rreth përfitimeve që mund t'i sjell një rrjet i organizatave, bizneseve dhe individëve në një shoqatë te tillë. Kjo përqindje e pashfrytëzuar është një mundësi për STIKK ta rris rrjetin biznesor.

22 Maj 2015

STIKK NËNSHKRUAN MARRËVESHJE PËR GRANT ME DONATORË PËR MBËSHTETJE TË STIKK EDUCATION

Kjo marrëveshje ka për synim krijimin e një programi për trajnim dhe punë praktike për të rinjtë në sektorin e TIK.

"Në vitin 2014, STIKK publikoi një raport mbi Analizën e Mangësive të Shkathtësive në Sektorin e TIK-ut, që ka theksuar se ekziston kërkesë e fuqishme në tregun vendor dhe të eksportit për ofrues të shërbimeve të TIK-ut", thotë Vjollca Çavolli, Drejtoreshë Ekzekutive e STIKK-ut. “Megjithatë, është një pengesë e madhe në realizimin e kësaj mundësie: mungesa e profesionistëve të arsimuar në Kosovë në një gamë profilesh të TIK-ut, siç janë programimi i softuerëve dhe kodimi, madje edhe marketingu apo administrimi i biznesit të TIK-ut. Kjo i vë ofruesit e shërbimeve të Kosovës në disavantazh, sidomos në marrjen e punëve që jepen jashtë vendit nga blerësit e BE-së.”

Si pjesë e STIKK, Akademia e Trajnimit përbehet nga dy cikle 6 mujore trajnimi që do të zhvillohen gjatë viteve 2015-2016. Zhvillimi i softuerëve, zhvillimi i aplikacioneve mobile dhe menaxhimi ne IT, janë tri fushat në të cilat do të ofrohet trajnim dhe certifikim në përputhje me Kornizën Evropiane për e-kompetenca 3.0 që siguron standardet ndërkombëtare për profilet e përcaktuara te shkathtësive te TIK.

Programi synon te rinjtë e papunësuar që janë të interesuar të ndjekin karriera në fushën e TIK.

Ky aktivitet bashkë-financohet nga GIZ, Ambasada e Norvegjisë dhe USAID.

Tetor 2015

ANALIZA E MANGËSISË SË SHKATHTËSIVE NË TIK



Analiza e mangësisë së shkathtësive në TIK vazhdon studimin e mëparshëm të STIKK të vitit 2011, duke ofruar një analizë krahasuese nga vija fillestare tashmë e vendosur, dhe duke u zgjeruar për të përfshirë vlerësimin e nevojave të sektorëve jashtë TIK-ut për një fuqi punëtore të kualifikuar të TIK-ut.

GJETJET KRYESORE:

Ngadalësimi i Sektorit. Situata në sektorin e TIK në Kosovë nuk ka ndryshuar shumë ne vitet 2011-2013. Sektori i Telekomunikimit dhe ai Financiar kanë tejkaluar Qeverinë si blerësi më i madh në tregun e TIK. Gjithashtu Qeveria nuk është fokusuar në krijimin e një mjedisi më fleksibil për sektorin e TIK, sektor të cilit I duhet një mjedis ku zhvillimi dhe rritja është e favorshme dhe e nevojshme që të përcillen hapat e zhvillimit të TIK ne botë.

Institucionet arsimore. Aktualisht pesë universitete në Kosovë ofrojnë diploma nga TIK: Universiteti i Prishtinës, Universiteti për Biznes dhe Teknologji, Universiteti Iliria, Universiteti i Prizrenit dhe Universiteti Universum, si dhe Universiteti Amerikan në Kosovë i cili ofron kurse të TIK-ut nga ofruesit komercial (jo diplomë). Studentet dhe Kompanitë e TIK ndajnë bindjen se programet studimore në universitete nuk ofrojnë saktësisht atë qe kërkohet nga industria, që studentët pranojnë më shumë teori dhe pothuajse aspak praktikë.

Institucionet dhe qendrat private të Arsimit dhe aftësimit profesional, dhe sidomos qendrat e trajnimit të ofruesve komercial, janë vlerësuar lartë nga të dy palët - studentët dhe punëdhënësit.

Analiza e Shkathtësive 2015 për sektorin e TIK në Kosovëështë në fazë përfundimtare, kjo analizë do të adresoi problemet e analizës së kaluar Rritja e sektorit? Ngritja e standardit te mësimdhënies për TIK në institucionet arsimore? Përkrahja e Qeverisë?).

15 Dhjetor 2015

LANSIMI I PROJEKTIT STIKK EDUCATION

Lansimin e projektit e përshëndetën dhe vlerësuan lart institucionet vendore: Ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale z. Arban Abrashi, Zëvendësministrja për Zhvillim Ekonomik znj. Besa Zogaj-Gashi, gjithashtu edhe donatorët që kanë bërë të mundur zhvillimin e programit: Ambasadori i Norvegjisë z. Jan Braathu, Ambasadori i SHBA-ve z. Greg Delawie dhe përfaqësuesja e GIZ znj. Elena Lau.

Ky projekt erdhi si përgjigje ndaj nevojës në rritje në tregun vendor dhe tregun e eksportit për zhvillues softuerik, të aplikacioneve për mobil dhe TI menaxher. Këto nevoja u vunë në dukje nga një analizë që STIKK bëri kohëve të fundit për mangësitë e shkathtësive në sektorin e TIK-ut në Kosovë.

Ky aktivitet bashkë-financohet nga GIZ, Ambasada e Norvegjisë dhe EMPOWER Sektori Privat i USAID-it.

Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore

22 Maj 2015

KONFERENCA E TI-SË TË EVROPËS JUG-LINDORE

Me 22 Maj në Sarajevë, u mbajt konferenca rajonale e Evropës Jug-Lindore (EJL) për Teknologji të Informacionit (SEE IT). Kjo konferencë mblodhi "cluster" dhe shoqata të TIK, kompani nga ato sapo të formuara deri tek ato të cilat kanë dekada përvojë në TIK dhe kompani nga sektorë të tjerë të cilat përdorin TIK-un në biznes-bërje. Ndër panelistet dhe pjesëmarrësit ishin edhe Drejtoresha Ekzekutive e STIKK, znj. Vjollca Çavolli, dhe Partneri Menaxhues dhe Themelues i CACTTUS, z. Driton Hapçiu.

Qëllimi kryesor i kësaj konference ishte krijimi i një ambienti efektiv për bashkëveprim dhe bashkëpunim të kompanive dhe për tregti të lirë në kuadër të EJL-së dhe BE-së. Shtete pjesëmarrëse në këtë konferencë ishin: Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Danimarka, Greqia, Gjermania, Holanda, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Norvegjia, Rumunia, Serbia, Sllovenia, Suedia, Shqipëria dhe Turqia. Kjo konferencë u organizua nga projekti i USAID "Partneriteti për Inovacion (PI)" nga Bosnja dhe Hercegovina, në bashkëpunim me projektin USAID REG dhe Fondin e Hapur Regjional për Promovim të Tregtisë së Jashtme.

25 Qershor 2015

DITA MBARËKOMBËTARE E TIK 2015

Me 25 Qershor në Durrës është mbajtur takimi i komunitetit të TIK të trojeve shqiptare: "Dita Mbarëkombëtare e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit". Kjo ngjarje ishte hera e 7-të me radhë e organizimit të këtij aktiviteti, i cili solli bashkë kompanitë e TIK nga Kosova dhe Shqipëria. Mbi 30 përfaqësues të sektorit të TIK u mblodhën në këtë takim me qëllim të identifikimit të mënyrave të ndryshme bashkëpunimit, njohjes, forcimit dhe krijimit e një rrjeti profesional mbarëkombëtar në fushën e TIK.

Takimi u hap nga Drejtori Ekzekutiv i AITA, z. Dritan Mezini, i cili u dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve. Më pas pjesëmarrësve iu drejtua Drejtoresha Ekzekutive e STIKK, znj. Vjollca Çavolli, e cila sqaroi se si u thellua bashkëpunimi gjatë këtyre 7-të viteve të vazhdimit të kësaj tradite.

Pjesëmarrësit gjithashtu patën kënaqësinë të dëgjojnë prezantimin e draftit të IT Barometrit të Kosovës për vitin 2015 nga z. Bardh Kadiu, Koordinator i Programeve në STIKK. Pas prezantimit, pjesëmarrësit patën mundësinë të kontribuojnë në diskutim të hapur lidhur me vështirësitë të cilat hasen në aspektin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve. Kompanitë vazhduan të shkëmbenin përvojat dhe njohuritë e tyre edhe gjatë koktejit të paraparë për rrjetëzim.

Kompanitë prezent në këtë takim vlerësuan lartë nevojën për vazhdimin e bashkëpunimit për tejkalimin e barrierave të identifikuara dhe krijimin e një ambient më të favorshëm për bërjen e biznesit.

03 Qershor 2015

SEMINARI "INXHINIERIA SOFTUERIKE NDËRKOMBËTARE: NJË STUDIM NGA PËRVOJA E HONEYWELL"

Me 3 Qershor, USAID, në bashkëpunim me FIEK (Universiteti i Prishtinës) dhe STIKK, organizoi seminarin me temën e Inxhinierisë Softuerike në përmasa Ndërkombëtare.

Përvojat e tyre i ndan Prof. Ronald Birks, nga Honeywell dhe Prof. Shahin Berisha, Inxhinier i Softuerit në Arizona State University. Globalizimi shtyu Honeywell nga SHBA-të të "outsource" në Indi, Kinë, Rusi dhe Meksikë. Prof. Birks pas punës së tij një vjeçare në Rusi, më shumë se katër viteve në Indi dhe më shumë se pesë në Francë, sqaron se si funksionon struktura e kompanive të cilat kanë seli të shumta në shtete të ndryshme të botës. Kompania fillon punën në projekt në SHBA, pasdite zhvillon konceptin në Republikën Çeke, zhvillimi vazhdohet në Indi dhe testimi bëhet në SHBA. Efikasiteti është marrë nga përvoja të viteve të gjata të punës dhe bashkëpunimit, veçanërisht me Universitetet për përshtatjen e kurrikules me kërkesat e tregut të punës.

Përveç mundësive të cilat i ofron Inxhinieria Softuerike në nivel Ndërkombëtar, aty ekzistojnë edhe shumë sfida. Disa të cilat vlen të cekën janë dallimi i gjuhëve, dallimi i zonës kohore, takime shumë të rralla fytyrë-me-fytyrë dhe koordinim i vështirë i proceseve. Duke u fokusuar në Kosovë, Prof. Birks vlerësoi nivelin e lartë të njohurisë së gjuhës Angleze dhe Gjermane, të pozitës gjeografike dhe moshës së re të punëmarrësve potencial të sektorit të TIK.

20-25 Prill & 27 Prill

NDËRMARRËSIT KOSOVAR KRIJOJNË LIDHJE ME BIZNESE NGA BERLINI DHE VIENA

Me 20-25 Prill STIKK në bashkëpunim me Capgemini Consulting, organizoi një aktivitet B2B (Biznes-me-biznes) në mes të ndërmarrësve nga sektori i TI-së, përfaqësuesve të STIKK, ICK, USAID programit si delegacion i Kosovës, me akterë të ndryshëm të sektorit të TI-së në Berlin dhe Gjermani në përgjithësi. Ky aktivitet është përkrahur nga GIZ dhe SPARK. Qëllimi i këtij udhëtimi ishte të ndërtohet një "brand" i industrisë së TI-së së Kosovës, të zhvillohet biznes-bërja dhe promovimi i eksportit B2B (nearshoring), të shkëmbehen përvojat dhe njohuritë mbi ndërmarrësinë dhe inovacionin, të krijohen partneritete strategjike dhe bashkëpunime në mes të inkubatorëve dhe akseleratorëve, të krijohen partneritete strategjike dhe bashkëpunime në mes të TI shoqatave dhe institucioneve dhe të vizitohen ngjarje në lidhje me risitë Teknologjinë e Informacionit, si: inteligjenca e tregut dhe rrjetëzimi.

Delegacioni Kosovar pati mundësinë të takohet me CHIC, Bundesverband Deutsche Startups e.V., Berlin Partner für Wirtschaft und Technologie GmbH for EEN, Startups in the Co-working Space Betahaus, Apps World Germany, Accelerator Plug & Play, European Pioneers, Accelerator Startup bootcamp and Coworking Space Rainmaking Loft, ITO Forum Germany, Coworking Space Factory Berlin, and Coworking Space Hub:Raum. Gjatë qëndrimit në Berlin, delegacioni gjithashtu është takuar me Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Gjermani, Skender Xhakaliu, ku është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit të ekonomive të Kosovës dhe Gjermanisë.

Metodologjitë të cilat janë përdorur gjatë takimeve: Prezantime nga ana e mikpritëseve, prezantime të industrisë dhe kompanive të TI-së në Kosovë, diskutim rreth mundësive të përbashkëta të biznes-bërjes, match-making joformal dhe rrjetëzime me kompani/startup dhe gjithashtu prezantim i mjedisit të punës.

Pas Berlinit, me 27 Prill, znj. Vjollca Çavolli, DE e STIKK, z. Bardh Kadiu, Kordinator i Programeve në STIKK, znj. Zana Tabaku, CEO i Appdec dhe z. Mentor Sahiti, CEO i Adaptiv IT vizituan Vienën për edicionin e 3-të të International Software Days, ku patën mundësinë të takohen dhe të diskutojnë me përfaqësues të kompanive nga i gjithë rajoni dhe Evropës pjesëmarrëse në këtë ngjarje.

28-29 Tetor 2015

#KOSICT15

Suksesi i KosICT-së erdhi si rezultat i folësve që e përcaktuan drejtimin e kësaj konference. Folësit, që vinin nga kompani eminente, ishin mirë të përgatitur dhe dhuruan sqarime të rëndësishme. Në temën realiteti virtual, prezantuan Florian Stadlbauer, Drejtor Ekzekutiv në Deck 13 Interactive, dhe z. Endri Tolka, Bashkëthemelues dhe Zyrtar i Lartë Operativ dhe Financiar në YouVisit. Pas tyre, z. Christian Kulas, Analist për Menaxhim Biznesi në Capgemini, z. Matthias Hamburg, Menaxher Konsultues për Sogeti në Gjermani, dhe z. Ermal Sadiku, Drejtor i Lartë Ekzekutiv në Linkplus prezantuan në temën Zhvillimi për Mobil. Në temën Industria 4.0 folësit ishin z. Rolf Glunz, Drejtor i Shitjeve në Imbus AG, z. Mentor Sahiti, Drejtor i Lartë Ekzekutiv në Adaptivit, z. Peter König, SAP Koordinator dhe Ligjërues në Kolegjin UBT, dhe z. Villu Arak, bashkëthemelues në Funderbeam. Në fund, tema për Internetin e Gjërave u mbulua nga z. Blaz Umek, Menaxher i Zhvillimit të Produktit në IPKO Telecommunications, z. Kiril Izov, Udhëheqës i organizatës SM&P për Microsoft-in në Bullgari, Maqedoni dhe Kosovë, z. Stoyan Boev, Drejtor Menaxhues në InterConsult Bulgaria, dhe z. Falk Schubert, Zv. President i Shitjeve për regjionin EMA në PAY.ON.

KosICT 2015 u organizua me ndihmën e shumë individëve dhe organizatave prestigjioze. Ky fakt u vërejt edhe në fjalimet hapëse. KosICT-ja u hap zyrtarisht nga z. Shkumbin Brestovci, President i Bordit të STIKK-ut. Në fjalimin e tij, ai u fokusua në rëndësinë dhe potencialin që Kosova ka në sektorin e IT-së. Pas z. Brestovci, fjalën e mori z.Blerand Stavileci, Ministër i Zhvillimit Ekonomik. Ai siguroi të pranishmit për mbështetjen e vazhdueshme që Qeveria e Kosovës i ka dhënë dhe do të vazhdoj të jap komunitetit të IT-së. Sesioni hapës përfundoi me znj. Christina Gehlsen, Zv. Ambasadore e Gjermanisë për Kosovë, e cila ju referua potencialit për outsourcing në IT dhe rëndësisë së KosICT si konferenca më e madhe regjionale.

3 Nëntor 2015

KONFERENCA IGNITE

Me datën 11 Nëntor 2015, përfaqësuesi i projektit të MFSII nga STIKK, z. Lorik Mullaademi morri pjesë si reprezentues i PAC (Partner Advisory Council) nga Kosova ku mbajti prezantim për arritjet e projektit në Kosovë nga 5 partnerët lokal. Sipas reprezentimit në PAC, Kosova ishte një shtetet me sukseset më të arritura në projektin e MFSII të lansuar në 2010 nga Ministria e Punëve te Jashtme e Holandës. Gjithashtu, STIKK mori pjesë në konferencën IGNITE të organizuar nga partneri ynë në Holandë, SPARK e cila kishte të bëj me zhvillimin e ndërmarrësisë në shtetet në zhvillim e sipër. Kjo konferencë synon për të krijuar një kuptim më të mirë të të bërit biznes në mjediset e vështira dhe të prekura nga konfliktet, dhe se si ne, si organizata të zhvillimit, institucionet akademike, organet qeveritare dhe kompanitë private, mund të mbështesin më mirë sipërmarrjen dhe të ndihmojë në lehtësimin e një mjedisi të biznesit më përfshirës në këto rajone.

25 Nëntor dhe 5 Dhjetor 2015

EXPORT PROMOTION SERVICES AND INNOVATION HUB PUNTORITE

STIKK Export Promotion Service (EPS)

Punëtoria për Export Promotion Service (EPS) e mbajtur në STIKK në bashkëpunim me GIZ u facilitua nga z. Lucas Von Zallinger, ku u diskutuan shërbimet e promovimit të eksportit për STIKK dhe partnerët e saj në kontekst të TIK. Partnerë të ndryshëm morren pjesë në punëtori duke përfshire Cacttus, LINK PLUS IT, ADAPTIV IT, ASSECO.

Disa çështje të përmendura gjatë punëtorisë:

- Probleme ne hulumtim të tregut dhe inteligjencës biznesore për sektorin e TIK në Kosovë;
- Çështje që pengon kompanitë në këtë industri është komunikimi i brendshëm i sektorit të TIK;
- Përgjigje e mangët në arritjet nga business leads.

Punëtoria dhe vazhdimësia e saj do të ndihmoi STIKK dhe partnerët e saj në zgjidhjen e këtyre pengesave që neglizhojnë operimin dhe funksionimin normal të shërbimeve të organizatës.

STIKK Innovation Hub

Qëllimi kryesorë i punëtorisë ishte promovimi i Innovation Hub që do ta ndihmonte zhvillimin e sektorëve te ndryshëm në tregun e Kosovës.

Industria e parë e përcaktuar për zgjidhje digjitale ishte industria e agrikulturës ku gjetja e zgjidhjeve të teknologjisë informative ndërmjet kompanive të IT dhe kompanive te agrikulturës, do të përafronin idenë e STIKK Innovation Hub e cila ka për qëllim zhvillimin e tregut të brendshëm përmes aplikimit të IT. z. Lucas Von Zallinger ishte facilitues i kësaj punëtorie e cila u mbajt në objektin e STIKK.

Kompanitë e TIK dhe Agros së bashku me reprezentues të ndryshëm nga industria e agrikulturës ishin pjesë e kësaj punëtorie ku pikat e diskutimit ishin:

- Fillimi i bashkëpunimit dhe njohja ndërmjet dy palëve;
- Kuptimi i nevojave të konsumatorit në industrinë e agrikulturës;
- Të nxënët për aftësitë dhe portofoliot e industrisë së IT në Kosovë;
- Promovimi i inovacionit digjital në agrikulture;
- Definimi i metodologjive të përbashkëta të bashkëpunimit dhe hapat e ardhshëm.

Tema kryesore dhe pengesat e hasura ishin:

Transformimi digjital i industrisë së Agrikulturës dhe vështirësitë e përcjelljes së hapave për procesin e transformimit. Problemi kyç është kthimi jo i mjaftueshëm financiar për operimet dhe shërbimet për digjitalizimin e industrisë së agrikulturës.

Kjo punëtori për Innovation Hub do të jetë një përpjekje për gjenerimin e zgjidhjeve për problemet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërmjet industrisë së TI dhe të agrikulturës dhe si mund të jetë financiarisht e përballueshme dhe profitabile.

03 Dhjetor 2015

BERANE TAKIMI ME PARTNERE

Projekti i CBC për zhvillim socio-ekonomik i kushtohet komunës së Istogut dhe Beranes, ku qëllimet kryesore janë zhvillimi ekonomik dhe social i qëndrueshëm duke shtyer inovacionin dhe ndërmarërsinë në industrinë e turizmit.

Me datën 3/12/2015 takimi i parë u zhvillua ndërmjet dy palëve në Berane, ku kryesisht u diskutua për mënyrat e bashkëveprimit ndërmjet dy komunave duke trajtuar zgjidhje të përbashkëta.

Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut

02 Prill 2015

KUVENDI I VII-TË I STIKK

Me 2 Prill në Qendrën e Inovacionit të Kosovës (ICK) u mbajt Kuvendi i STIKK. Pjesëmarrës në kuvend kanë qenë bordi i drejtorëve i STIKK, përfaqësuesit e kompanive anëtare, anëtarët individual, donator dhe përfaqësues të tjerë të organizatave jo-qeveritare dhe institucioneve vendore. Hapjen e Kuvendit e bëri kryetari i Bordit të STIKK, z. Shkumbin Brestovci, i cili pas një përshëndetje për pjesëmarrësve i dha fjalën Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Blerand Stavileci. Ministri në fjalimin e tij përshkroi bashkëpunimin në mes të Ministrisë së tij dhe STIKK dhe si planifikohet të bëhet zhvillimi i sektorit të TIK, duke marr si shembull krijimin e fondit për zhvillim dhe inovacion.

Pas Ministrit, fjalën e morri Ambasadori i Mbretërisë Norvegjeze në Kosovë, z. Jan Braathu, i cili përgëzoi pjesëmarrësit për kuvend dhe sqaroi se sa dhe pse është aq i madh interesimi i tij dhe i Mbretërisë Norvegjeze për sektorin e TIK të Kosovës. Duke marr si shembull shtetin Norvegjez, ai përshkroi se çfarë ndikimi të madh ka sektori TIK në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, duke kontribuuar edhe në sektorë të tjerë. Fjalët përshëndetëse i përmbylli zëvendës ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, z. Matthias Kiesler. Zotëri Kiesler shprehi interesimin e tij të madh në sektorin e TIK dhe se beson se ky sektor është ndër sukseset e mëdha në Kosovë.

Pas fjalimeve përshëndetëse, z. Shkumbin Brestovci vazhdoi me prezantimin e aktiviteteve ndërkombëtare dhe aktiviteteve të Bordit të STIKK. Ndër të arriturat e STIKK në vitin 2014, z. Brestovci numëroi organizimin dhe pjesëmarrjen e mbi 15 konferencave dhe takime B2B (vendore dhe ndërkombëtare), 7 publikime të përgatitura me fokus në TIK dhe avokimin për miratim të Ligjit për Mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor. Pas kryetarit të bordit, Drejtoresha Ekzekutive e STIKK, znj. Vjollca Çavolli prezantoi më gjerësisht se çfarë aktivitete ka zhvilluar STIKK gjatë vitit 2014. Aktivitetet e ndara në pesë objektiva tregojnë se si STIKK ndihmon në zhvillim të një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK, zhvillim të burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut, ofron shërbime për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore, krijon kushte për veprimtari të qëndrueshme të shoqatës dhe mbështet anëtarët në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK.

Pjesa punuese e Kuvendit vazhdoi pasdite, e cila me aprovim të agjendës së punës, formimin e kryesisë së punës dhe komisionit punues për numërim të votave. Pas asaj, raporti vjetor i STIKK pas diskutimit në mes të anëtarëve është aprovuar. Në vazhdim z. Vigan Budima prezantoi planin e punës për vitin 2015 dhe si pjesë e diskutimit u shtua si aktivitet edhe themelimi i STIKK Innovation Hub, e cila do të ofrojë përkrahje anëtareve në krijimin e mundësive të reja biznesore me sektorët e tjerë vertikal.

01 Tetor 2015

LANSIMI I WWW.STIKK.ORG



STIKK.ORG është një hap i rëndësishëm për STIKK-un ku STIKK si organizatë zgjeron platformën në të cilën anëtaret e këtij asociacioni dhe çdonjëri me qasje në internet ka mundësinë të merr informatë online rreth publikimeve të STIKK.

Kjo ueb faqe ka kategori, si:

- Informatë **rreth STIKK** (Objektivat, Projektet, Raportet, Kontakti, Stafi);
- **Iniciativat** është kategoria e dytë ku listohen projekte te ndryshme të STIKK si: ICK, KosICT, STIKK Education dhe Kosovo – Your Outsourcing Destination;
- **Publikimet** është kategoria e tretë ku Publikimet dhe Dokumente Politikash të STIKK mund të shfletohen elektronikisht, apo të ngarkohen në pajisje digjitale;
- **Anëtaret** është kategoria me radhe ne te cilën listohen të gjithë anëtarët që zgjodhën STIKK si asociacion për të zgjeruar rrjetin biznesor në sektorin e TIK.

Këtu janë ndër kategoritë kryesore të ueb faqes të STIKK, si platformë informative ku synimi kryesorë është që të gjitha palët, kompanitë, organizatat, individët të kenë qasje në informatat më të fundit te organizatës në çdo kohe.

Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK

19 Janar, 19 Maj dhe 23 Dhjetor, 2015

DHURIMI I GJAKUT

Këtë vit u organizua 3 herë aksioni për dhurim të gjakut. Në ambientet e ICK-së janë mbajtur aksionet e dhurimit të gjakut, aksione te cilat tashmë janë bërë traditë e shoqatës sonë. Dhuruesit kanë qenë nga STIKK, ICK, përfaqësues të kompanive anëtare të STIKK, ekipet e inkubatorit të ICK-së, si dhe njerëz të tjerë që nuk janë pjesë e qendrës.

Aksioni i dhurimit të gjakut u mbajt në zonën "Events Area", ku në dispozicion ishin 4 shtretër që së bashku me pajisjet tjera përcjellëse u siguruan nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET

Të hyrat

Gjatë vitit 2015, të hyrat e STIKK ishin **375,471.07€** (15.04% më shumë krahasuar me 319,007€ të vitit 2014) dhe atë nga 5 burime të mjeteve: Programi i BE-së Cross-Border Cooperation, Microsoft, Ambasada Norvegjeze, GIZ dhe SPARK, dhe Anëtarët e STIKK (anëtarësia, participimi në trajnime dhe aktivitete tjera). Detajet e të hyrave janë të prezantuara në tabelën në vazhdim:

	CBC	Microsoft	Norwegian Embassy	GIZ	GIZ Local Subsidy	SPARK 2015	STIKK	TOTAL
Ordinary Income/Expense								
Income								
Total Income								
Membership Fees	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	15,420.00	15,420.00
Other Income	0.00	10,364.62	0.00	0.00	0.00	0.00	3,262.86	13,627.48
Program Income	191,671.00	0.00	20,000.00	13,000.00	35,636.00	47,494.59	31,182.00	338,983.59
Program Service Fees	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	7,440.00	7,440.00
Total Income	191,671.00	10,364.62	20,000.00	13,000.00	35,636.00	47,494.59	57,304.86	375,471.07

Shpenzimet

Gjatë periudhës raportuese, shpenzimet e STIKK arritën shumën prej **202,685.96€** (38.08% më pak krahasuar me 325,881€ në vitin 2014). Disa nga projektet nuk janë mbyllur këtë fundvit, pasi që edhe kontratat, por edhe kohëzgjatja është e ndryshme. Dallimi mes të hyrave dhe shpenzimeve vjen në saje të projekteve të cilat fillojnë në 2016, ndërsa financimi ka filluar në 2015. Pasqyra e shpenzimeve në detaje është e prezantuar ne tabelën në vazhdim:

	CBC	Microsoft	Norwegian Embassy	GIZ	GIZ Local Subsidy	SPARK 2015	STIKK	TOTAL
Expense								
Admin Costs/Operations								
Bank Charges	287.50	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	555.86	843.36
Maintenance	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	153.12	153.12
Marketing & Advertising	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	7,045.21	1,310.16	8,355.37
Membership	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	200.00	200.00
Office Rent	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	6,382.56	6,382.56
Office Rent Tax	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	377.94	377.94
Office Supplies	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	935.39	935.39
Phone & Fax	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,031.02	1,031.02
Postage, Mailing Service	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	59.35	63.49	122.84
Printing and Copying	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	324.79	75.30	400.09
Representation				4.50			1,166.57	1,171.07
Utilities	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	5.00	5.00
Facilities and Equipment	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,700.90	1,700.90
Humbjet nga ushtrimi i veprimt.								
Negative diff. of exchange rate	0.00	0.00	516.32	0.00	0.00	0.00	104.70	621.02
Zbritjet e leshuara per antare	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,016.00	1,016.00
International travel & transp.								
Accomodation	0.00	0.00	0.00	0.00	2,600.00	3,064.00	1,215.34	6,879.34
International travel	0.00	0.00	0.00	0.00	3,496.00	3,203.75	1,126.00	7,825.75
Other expenses	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	18.80	433.48	452.28
Per Diem	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	2,585.40	2,585.40
Local and Regjional travel								
Local Travel	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	400.00	626.80	1,026.80
Local Travel - Self Vehicle	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	933.60	933.60
Local and Regjional travel - Other	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	262.71	262.71
Meetings								
Board and Assembly Meetings	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,466.59	1,466.59
Other Expenses	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	18.20	18.20
Presentation & Event expenses								
Event expenses	0.00	5,050.00	150.00	49.77	0.00	4,918.20	5,770.63	15,938.60
Marketing & Advertising	0.00	3,311.23	0.00	0.00	0.00	852.82	10,714.00	14,878.05
Presents for Events	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	4,455.40	4,455.40
Translation	0.00	1,221.60	0.00	0.00	0.00	0.00	337.99	1,559.59
Profesional Services								
Accounting Services	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	359.60	359.60
Auditing	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	2,111.20	2,111.20
Consultancy	0.00	0.00	2,500.00	0.00	29,540.00	0.00	0.00	32,040.00
Freight forwarder	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	30.00	30.00
Legal Services	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	59.00	59.00
Salary long term Local Staff								
Executive Director	0.00	0.00	1,200.00	0.00	0.00	7,992.85	14,960.63	24,153.48
Finance Officer	0.00	0.00	640.00	0.00	0.00	4,158.00	5,969.42	10,767.42
Finance Officer -Assistant	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	3,957.78	3,957.78
Intern	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,125.00	1,125.00
Member relations Coordinator	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	12,609.49	12,609.49
Programme Manager	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	8,208.25	8,208.25	16,416.50
Project Assistant 1	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	3,989.34	3,989.34
Project Manager SPARK	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	9,655.27	3,813.89	13,469.16
Travel and Meetings B2B								
Travel	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-900.75	-900.75
Total Expense	287.50	9,582.83	5,006.32	54.27	35,636.00	49,901.29	102,217.75	202,685.96

MBLEDHJET E BORDIT

Gjatë vitit 2015 u mbajtën gjithsej tre mbledhje të rregullta të Bordit të STIKK (11 Shkurt, 13 Maj dhe 15 Shtator).

Me 11 Shkurt, 2015, në mbledhjen e tridhjetetetë (të jashtëzakonshme), ku janë diskutuar çështjet në vijim:

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e tridhjeteshtatë (e rregullt) mbajtur më 13 Nëntor 2014;
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK;
3. Diskutimi dhe aprovimi i raportit vjetor te STIKK;
4. Diskutimi dhe miratimi i planit te punës dhe burimeve të mjeteve për 2015;
5. Organizimi i Kuvendit të 7-të të STIKK:
    a. Caktimi i datës,
    b. Caktimi i lokacionit,
    c. Votimi dhe përzgjedhja e anëtarëve të rinj të Bordit,
    d. Shpërndarja e përgjegjësive anëtarëve te Bordit për mbledhjen e Kuvendit Vjetor,
    e. Të ndryshme.

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

1. Plani i punës final të ju dërgohet për komente;
2. Caktohet takimi brenda 1 jave;
3. Caktohet data e Kuvendit Vjetor për 26 Mars, në ICK (por që më vonë u rivendos me 2 Prill për shkak të aspekteve logjistike);
4. Caktohet z. Shkumbin Brestovci për raportim të punës së bordit;
5. Caktohet z. Vigan Budima për prezantim të planit të punës dhe burimeve të mjeteve;
6. Kërkohet të bëhet përmirësimi i dokumentit politikash për shkallëzimin e TVSH;
7. Vendoset që të ju dërgohet koncepti i STIKK Training Academy bordit me email, gjithashtu të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme e bordit me vetëm këtë pikë rendi të ditës.

Me 13 Maj, 2015, në mbledhjen e tridhjetenëntë, ku janë diskutuar çështjet në vijim:

Rendi i ditës:

1. Mirëseardhje anëtareve te rinj te Bordit;
2. Përcaktimi i nënshkruesit te dyte për transaksionet financiare te STIKK;
3. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e tridhjetetetë (e rregullt) mbajtur më 11 Shkurt 2015;
4. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK;
5. Raportimi mbi punën e ICK gjate vitit 2014;
6. Të ndryshme:
    a. Organizmi i BBQ për anëtaret e STIKK,
    b. Bordi i ICK.

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

1. Ne mënyrë unanime z. Arben Ymeraga zgjidhet nënshkruesi i dytë financiar;
2. Miratuan unanimisht Procesverbalin e mbledhjes së tridhjetetetë të Bordit të STIKK;
3. Aprovohet raporti 3 mujor i STIKK.

Me 15 Shtator, 2015, në mbledhjen e katërdhjetë, ku janë diskutuar çështjet në vijim:

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e tridhjetenëntë (e rregullt) mbajtur më 13 maj 2015
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK
3. Të ndryshme

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

1. Miratuan unanimisht Procesverbalin e mbledhjes se tridhjetenëntë te Bordit te STIKK;
2. Aprovohet raporti 3 mujor i STIKK.

PËRMBYLLJE

Viti 2015 filloi me një tempo të ngadalshëm për shkak të situatës politike në Kosovë, kjo ngecje ishte shkak që donatorët u vonuan në aprovimin e projekt propozimeve nga STIKK, rrjedhimisht kjo situatë i ngadalësoi aktivitetet e organizatës tonë.

Fillimi i Çerekut të tretë i vitit të kaluar përmbante aktivitete të rëndësishme që përshpejtuan dhe shpeshtuan aktivitetet e organizatës. Një sukses i madh për atë periudhë është lobimi dhe avokimi i STIKK që shtyu Administrata ten Tatimore te Kosovës (ATK) të nxjerr Udhëzimin Administrativ në të cilin pajisjet e TIK do të kenë normën e reduktuar të TVSH prej 8%. Me këtë lobim të suksesshëm dy vjeçar, tregu i TIK në Kosovë është më fleksibil për shkak të qasjes së lehtësuar për pajisje teknologjike.

Hovi i aktiviteteve nuk u ndal pas kësaj periudhe. Konferenca rajonale KosICT ndër vite po fuqizohet në rrjetëzim, edhe këtë vit organizimi i konferencës filloi dhe përfundoi me sukses duke informuar të pranishmit me folës të ndryshëm, me pajisje teknologjike (VR) si shembull konkret për njërën nga temat e këtij viti. Dy hulumtime janë publikuar “IT Barometer 2015” dhe “Identifikimi i nevojave të tregut të punës në sektorin e TIK-ut”. Cross-Border Cooperation projekti nga EU ka filluar me takimin në Dhjetor ndërmjet dy palëve për të shtjelluar aktivitetet e projektit. STIKK Education projekti për trajnim dhe punë praktike për të rinjtë u lansua me 15 Dhjetor, lansimi i së cilës ishte i suksesshëm, me folës të ndryshëm që e prezantuan projektin dhe vizionin e projektit.

Viti 2016 është një vit me rëndësi për STIKK, partnerët dhe të gjithë akterët në sektorin e TIK. Avokimi dhe lobimi për një shoqëri më të integruar digjitale, një KosICT më të rrjetëzuar, hulumtime të ndryshme për sektorin e TIK, punëtoritë të ndryshme për STIKK dhe partnerët, këto janë disa prej prospekteve të STIKK për këtë vit.

Prishtinë,

Janar, 2016

STIKK